

OBSERVATORI I EKONOMIVE TË PALIGJSHME NË EVROPËN JUGLINDORE

NUMRI

15 MAJ 2023

Përmbledhje e pikave kryesore



Kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme është një industri gjithnjë e në rritje në Kosovë.

Para vitit 2019, kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme në Kosovë ishte një fenomen i rrallë dhe kryesisht bëhej për përdorim personal. Megjithatë, në tre vitet e fundit ka pasur një rritje në shkallë të gjerë të kultivimit të kanabisit në laboratorë – shumica e të cilit kishte për qëllim të shitej në tregje të huaja. Përmes analizimit të të dhënave primare dhe intervistave me zyrtarët dhe ekspertët kryesorë, ky artikull eksploron arsyet që fshihen pas rritjes, zonave të nxehta të kultivimit dhe profilit të personave të arrestuar për këtë vepër penale.



Të miturit e pashoqëruar përballen me udhëtime të vështira gjatë rrugës së emigrimit nga Ballkani Perëndimor në BE.

Fëmijët e pashoqëruar që udhëtojnë në BE përmes Ballkanit Perëndimor janë mjaft të rrezikuar për të rënë pre e trafikimit të qenieve njerëzore dhe e shfrytëzimit seksual. Numri gjithnjë në rritje i të miturve të

pashoqëruar që udhëtojnë përmes Ballkanit, sidomos të rinjtë nga Afganistani, vetëm sa e kanë përkeqësuar problemin. Komunikimi dhe koordinimi më i mirë mes agjencive të zbatimit të ligjit dhe organizatave që punojnë në kampet e emigrantëve janë të nevojshme për të mbrojtur fëmijët që lëvizin.



Grupet kriminale shqiptare të organizuara janë bërë aktorë kryesorë në mjedisin kriminal të Italisë, duke ngritur nevojën për operacione të posaçme nga autoritetet.

Grupet kriminale shqiptare në Itali kanë evoluar nga autorët e veprave penale të vogla në aktorë të rrezikshëm në ekonomi të caktuara të jashtëligjshme, si trafikimi i kokainës dhe kanabisit. Këto grupe e kanë zgjeruar fushën e veprimtarisë së tyre nga qytetet e mëdha, si Roma, te qytetet e vogla dhe komunitetet rurale, sidomos në veri të vendit. Ato kanë legjitimizuar rolin e tyre si partnerë të barabartë në mafian tradicionale italiane, duke bërë që zbatimimi i ligjit në vend t'i përqendrojë gjithnjë e më shumë operacionet e tij në këto grupe të stilit të mafiave nga Shqipëria.



RRETH KËTIJ NUMRI

“Buletini i rreziqeve” i prodhuar nga Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore i Iniciativës Globale Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar zakonisht jep informacion lidhur me çështjet aktuale të krimin të organizuar të profilit të lartë. Numri i 15-të përqendrohet te zhvillimet e krimin të organizuar në rajon, të cilat kanë tërhequr më pak vëmendjen e publikut, por që duhet të monitorohen po njëjloj.

Si fillim i drejtohem Serbisë, ku një propozim i qeverisë për rregullimin e policisë është përballur me kundërshtimin e publikut. Projektligji për policinë jo vetëm që shihet një kërcënim i mundshëm ndaj të drejtave të qytetarëve, por përmban edhe disa mangësi për të luftuar krimin e organizuar. Ndërsa qeveria mban konsultime publike me shoqërinë civile dhe sindikatat e policisë për të rihartuar ligjin, mbetet ende për t’u parë nëse rregullat e reja policore do ta ndihmojnë vendin të arrijë rekomandimet e përcaktuara nga Komisioni Evropian.

Dy tregjet kriminale që marrin pak vëmendje në Ballkanin Perëndimor janë trafikimi i objekteve antike dhe kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme. Artikulli i dytë dhe i tretë hedhin dritë mbi këto probleme, duke eksploruar mënyrën se si trafikimi i objekteve antike kërcënon trashëgiminë kulturore të Maqedonisë së Veriut dhe duke parë arsyet që fshihen pas rritjes së kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme në Kosovë.

Në vazhdim të fokusit tonë te pikat e nxehta të ekonomive të paligjshme në Evropën Juglindore, shohim qytetin boshnjak Gradiška, i cili shtrihet pranë kufirit me Kroacinë. Edhe pse qyteti ka qenë prej kohësh një qendër e trafikimit, duket se është bërë një rrugë kalimi për trafikantët që duan të depërtojnë në tregjet e BE-së që kur Kroacia hyri në zonën Schengen në fillim të vitit 2023.

Një rrezik tjetër që merr pak vëmendje është numri i madh i fëmijëve që lëvizin përmes rrugës së Ballkanit drejt BE-së, shumë prej të cilëve po ua mbathin shkeljeve të të drejtave të njeriut në vendet e tyre. Kësaj i shtohen edhe rreziqet e shfrytëzimit gjatë udhëtimit të tyre. Rrallëherë dëgjoen historitë e tyre, ngaqë ata nuk duan të tregojnë nga frika se mos ndëshkohen apo se mos i kthejnë në shtëpi.

Një synim i vazhdueshëm i këtij “buletini të rrezikut” është të monitorohen aktivitetet e grupeve kriminale të Ballkanit Perëndimor që operojnë jashtë rajonit. Artikulli i fundit në këtë numër flet për rritjen e mafies italo-shqiptare, të grupeve kriminale që kanë depërtuar në mjedisin e krimin të organizuar në Itali.

Si gjithnjë, duam të dimë komentet dhe sugjerimet tuaja për histori të reja. Nëse doni të na kontaktoni ose nëse keni ndonjë ide për një histori, ju lutemi të kontaktoni Vanja.Petrovic@globalinitiative.net.

Kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme është një industri gjithnjë e në rritje në Kosovë.

Kanabisi është droga e jashtëligjshme më e konsumuar në Ballkanin Perëndimor dhe në BE, dhe tregtia e tij llogaritet në rreth 38% të tregut të shitjes me pakicë të drogës në BE.¹ Anëmbanë botës, kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme ia ka kaluar kultivimit në natyrë.² Grupet kriminale nga Ballkani Perëndimor po përfshihen gjithnjë e më shumë në kultivimin e kanabisit në ambiente të brendshme në Evropë.³

Në Indeksën Botërore të Kriminës së Organizuar 2021, Kosova – një destinacion dhe vend tranzit për drogën – arriti vlerësimin 5.5 për sa i përket tregtisë së paligjshme të kanabisit, një nivel më i lartë se mesataret botërore (5.10) dhe evropiane (4.88) dhe paksa më i ulët se mesatarja në Ballkanin Perëndimor (5.90).⁴ Kultivimi i kanabisit ka qenë një vepër penale relativisht e rrallë në Kosovë, dhe kryesisht ndodhte në zonat e thella pranë Pejës, Gjakovës, Podujevës, Gjilanit dhe Suharekës.⁵ Edhe pse ka pasur përpjekje për të kultivuar sasi të mëdha të kanabisit në natyrë, policia e Kosovës arriti t'i zbulonte plantacionet në fazë të hershme dhe t'i

shkatërronte grupet kriminale. Policia arriti ta bënte këtë pavarësisht kapaciteteve të kufizuara të saj, duke pasur mungesë të helikopterëve dhe dronëve.⁶ Kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme ka qenë edhe më i rrallë, dhe kryesisht përfshinte raste të kultivimit të kanabisit në apartamente për përdorim personal.

Nga viti 2019 deri në 2023, në Kosovë janë raportuar 3 990 raste të trafikimit të drogës, për të cilën u arrestuan 4 267 njerëz. Vetëm 2,6% e këtyre rasteve dhe 2,1% e personave të arrestuar kishin lidhje me kultivimin e kanabisit (në ambiente të brendshme dhe të jashtme).⁷ Megjithatë, që prej vitit 2022 ka pasur një trend në rritje të zbulimit të laboratorëve të kanabisit dhe rritje të numrit të arrestimeve. Në vitin 2022, policia zbuloi 10 laboratorë dhe arrestoi 28 persona. Këta ishin numrat më të lartë të arrestimeve dhe laboratorëve të zbuluar që prej vitit 2019, me sa duket për shkak të rritjes së numrit të këtyre laboratorëve si edhe ndjekjes intensive nga policia.⁸ Edhe pse shumica e kanabisit të prodhuar në ambiente të brendshme kishte si qëllim




FIGURA 1 Numri i laboratorëve të zbuluar të kanabisit dhe i njerëzve të arrestuar për kultivimin e kanabisit, 2019-2022.

Burimi: Policia e Kosovës

tregjet e huaja në Evropë dhe Turqi (ku shpesh shkëmbehet për heroinë), sasi të vogla shiten edhe në tregun vendës.⁹

Kanë qenë disa faktorë që kanë çuar në rritjen e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme në Kosovë. Intensifikimi i operacioneve nga Policia e Shtetit në Shqipëri për të shkatërruar prodhimin e kanabisit në natyrë në Shqipëri e ka bërë më të vështirë prodhimin dhe trafikimin e kanabisit nga Shqipëria. Kjo ka bërë që të trafikohen sasi më të vogla në rajon me një çmim më të lartë. Meqë Kosova është edhe destinacion, edhe vend tranzit për drogën, çmimi i kanabisit ka filluar të rritet çdo vit, sidomos që prej vitit 2019.¹⁰ Deri më tani, asnjë shtetas shqiptar nuk është arrestuar në rastet e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, megjithëse janë bërë disa arrestime për trafikimin e drogës në Kosovë.

Një faktor tjetër është se kanabisi i kultivuar në ambiente të brendshme ka përqindje më të lartë të tetrahidrokanabinolit (THC).¹¹ Të dhënat nga vendet evropiane tregojnë se potencia dhe çmimi i kanabisit janë rritur që prej vitit 2006.¹² Anëmbanë botës, rritja e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme ia ka kaluar kultivimit në natyrë¹³ dhe prandaj ka një rritje të kërkesës për kanabisin e kultivuar në ambiente të brendshme në Kosovë, në Evropë e kudo tjetër.¹⁴

Përveç kësaj, fitimi prej kultivimit në ambiente të brendshme është më i lartë krahasuar me kultivimin në natyrë, pasi pa rendiment më të lartë dhe rritje më të shpejtë – deri në gjashtë korrije në vit.¹⁵ Në tregun e brendshëm të Kosovës, çmimi me shumicë për 1 kilogram kanabis të prodhuar në ambiente të brendshme është midis 2 000 € dhe 2 500 €, krahasuar me 800 € deri në 1 600 € për kilogram kanabis të prodhuar në natyrë. Në rajon, kanabisi i prodhuar në ambiente të brendshme ka çmimin rreth 3 000 €; në Turqi ka arritur pothuajse 6 000 € për kilogram.

Gjithashtu, rreziku i zbulimit të laboratorëve është më i ulët krahasuar me plantacionet e kanabisit në natyrë.¹⁶ Jo vetëm që është më e lehtë të mbrohen plantacionet në ambiente të brendshme, por teknologjia u jep mundësi kultivuesve të kontrollojnë nga distanca ujitjen dhe temperaturën, si dhe të monitorojnë sigurinë e laboratorit nëpërmjet kamerave. Gjithashtu është e nevojshme të shkohet më pak te vendi, dhe kjo bën që kultivuesit të ekspozohen më pak ndaj zbatimit të ligjit dhe komshinjve. Ndryshe nga kjo, bimët e mbjella jashtë janë të ekspozuara ndaj kushteve të ndryshme të motit që mund të ndikojnë te prodhimi, janë të dukshme pavarësisht se ndodhen në vende të largëta dhe kërkojnë që të vizitohen më shpesh.




FIGURA 2 Faktorët që ndikojnë te kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme në Kosovë.




FIGURA 3 Laboratorët e zbuluar nga komuna.

Burimi: Policia e Kosovës dhe përlogaritjet e GI-TOC

Veriu i Kosovës ka qenë një pikë e nxehtë e krimit, trafikimit të mallrave të ligjshme dhe të paligjshme, dhe e prodhimit të kriptomonedhave, dhe ka qenë një strehë për kriminelët dhe personat në kërkim.¹⁷ Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga institucionet qeveritare dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, zona mbetet gjerësisht e pakontrolluar. Integriteti territorial është një nga 12 elementët përbërës për qëndrueshmërinë ndaj krimit të organizuar të llogaritur në Indeksin Global për Krimin e Organizuar, në të cilin Kosova arriti 3.5 pikë nga 10 gjithsej – më i ulëti në Ballkanin Perëndimor.¹⁸ Mungesa e kontrollit të efektshëm e territorit në veri të Kosovës, e shoqëruar me energjinë elektrike falas, afërsinë me Serbinë dhe bashkëpunimin me grupet kriminale aty ka bërë të mundur rritjen e laboratorëve të kanabisit në këtë rajon.¹⁹


Legalizimi i prodhimit të kanabisit në Maqedoninë e Veriut dhe prodhimi ekstrakteve të kërpit për qëllime mjekësore ka mundësuar shtimin e njohurive dhe ekspertizës në ndërtimin e laboratorëve. Ekziston dyshimi se disa inxhinierë nga Maqedonia e Veriut, të cilët u arrestuan në Kosovë, dhanë ndihmë profesionale në krijimin e laboratorëve.²⁰ Përveç kësaj, 50 kilogramë kanabis nga Maqedonia e Veriut u konfiskuan në Kosovë në vitin 2020. Besohet se u trafikuan nga laboratorët e ligjshëm në Maqedoninë e Veriut.²¹ Fakti që 1.5 ton kanabis u vodhën nga magazina të licencuara në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022 tregon se kanabisi i prodhuar ligjërisht po dërgohet në tregje të paligjshme në vend ose jashtë vendit.²²

Së fundmi, pavarësisht kufizimeve për të lëvizur gjatë pandemisë COVID-19, grupet e krimt të organizuar në Ballkanin Perëndimor u treguan elastike, duke i përshtatur metodat e veprimtarive për t'u përballur me vështirësitë në modelin e biznesit të tyre të jashtëligjshëm.²³ Edhe pse duket se në treg ka pasur më pak kanabis gjatë muajve të parë të kufizimit të lëvizjes,²⁴ konsumi i kanabisit është rritur më shumë për shkak të përdorimit më të shpeshtë dhe më intensiv.²⁵ Ngaqë pandemia ka rritur më tej pabarazinë dhe ka kufizuar mundësitë për punësim, ajo mund t'i ketë shtyrë disa njerëz që t'i drejtohen kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.²⁶ Prandaj duket se pandemia ka kontribuar në rritjen e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme në Kosovë.

Në vitet 2019–2021, shumica e katër laboratorëve të zbuluar ishin të vegjël ishin zbuluar në Prishtinë; në vitin 2022, gjysma nga 10 laboratorët të zbuluar u gjetën në veri të Kosovës.²⁷ Besohet se laboratorët në veri u krijuan në fund të vitit 2021 dhe fillim të vitit 2022.²⁸ Zbulimi i tyre ishte rezultat i pranisë dhe operacioneve më të shtuara nga zyrtarët policor dhe doganorë, në veçanti për të penguar trafikimin e mallrave të paligjshme dhe prodhimin e paligjshëm të kriptomonedhave. Nga rrënjët e kanabisit dhe kanabisi i konfiskuar në laboratorët në Kosovë në vitet 2019–2022, 79% e bimëve dhe 91% e kanabisit u konfiskuan në veri.²⁹ Pajisjet laboratorike kishin origjinën nga Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.³⁰

Policisë së Kosovës i mungojnë kapaciteti dhe ekspertët e nevojshëm për të përcaktuar vlerën e rrënjëve të konfiskuara të kanabisit dhe pajisjeve të përdorura në laboratorët e paligjshëm; raportet e policisë tregojnë vetëm një vlerë të përafërt të kanabisit në tregun e Kosovës.³¹ Duke u bazuar në përlogaritjet e policisë, vlera e përgjithshme e kanabisit dhe pajisjeve të konfiskuara në vitet 2019–2022 është midis 24 dhe 28 milionë €. ³² Megjithatë kjo përlogaritje mund të jetë mjaft e ulët. Kryeministri i Kosovës ka deklaruar se pesë laboratorët e paligjshëm të zbuluar në veri janë përlogaritur në disa qindra milionë euro, një mbivlerësim në mospërputhje me të dhënat zyrtare të secilit operacion.³³

Një nga laboratorët më të sofistikuar u zbulua në maj 2022 pranë Izvorit, pikës së kalimit kufitar me Serbinë. 9 084 rrënjët e kanabisit që u konfiskuan atje supozohen të jenë rendimenti i dytë.³⁴ Ky laborator kishte pajisje dhe teknologji të avancuar, si ujitje dhe ventilim të kontrolluar në distancë, si dhe kamera survejimi, të cilat



Një laborator i kanabisit i zbuluar pranë pikës së kalimit kufitar të Izvorit, në veri të Kosovës.

Foto: Policia e Kosovës

shmangnin nevojën për të shkuar shpesh te objekti me sipërfaqe 1 200 metra katrorë.³⁵ Vlera e përlogaritur e laboratorit dhe e pajisjeve është afërsisht 1 milion €. ³⁶ Fillimisht policia mendonte se ambienti po përdorej për prodhim të paligjshëm të kriptomonedhave për shkak të zhurmës së lartë të shkaktuar nga sistemi i ventilimit. Ata kryen një operacion të përbashkët me zyrtarët doganorë, gjatë së cilës u qëlluan me armë zjarri; keqbërësit arritën t'ia mbathnin.³⁷ Të dyshuarit në këtë çështje janë identifikuar por nuk janë arrestuar ende, pasi raportohet se ia kanë mbathur jashtë vendit.³⁸

Në shkurt 2022 u zbulua një laborator në katin e shtatë të një mulliri në Suharekë, pranë Prizrenit, në jug të Kosovës. Mulliri ishte zgjedhur për të shmangur dyshimet në lidhje me konsumin e lartë të energjisë.³⁹ Policia konfiskoi më shumë se 2 000 rrënjë dhe 3,2 kilogramë kanabis, me një vlerë në treg prej më shumë se 1 milion €. ⁴⁰

Profili dhe kombësia e keqbërësve ndryshon sipas rajonit të cilin ndodheshin laboratorët, megjithatë të gjithë ishin burra të moshave 20 deri në 40 vjeç.⁴¹ Shtetas serbë dhe serbë etnikë nga Kosova u arrestuan në laboratorët e zbuluar në veri. Në laboratorin e




FIGURA 4 Kombësia/prejardhja etnike e personave të arrestuar për kultivimin e kanabisit në ambiente të brendshme, 2019–2022.

Burimi: Policia e Kosovës

Suharekës, u arrestuan dy kosovarë, së bashku me një shtetas turk dhe katër shtetas nga Maqedonia e Veriut. Këta të fundit, të cilët ishin të gjithë inxhinierë, dyshoheshin se ishin ekspertë në instalimin e pajisjeve dhe në aktivitetet e kultivimit në Suharekë dhe në laboratorë të tjerë në veri. Autoritetet dyshojnë se shtetasi turk bashkëpunonte me këtë grup për të transportuar kanabis në Turqi.⁴² Shtetasit e Maqedonisë së Veriut u arrestuan gjithashtu në laboratorët e zbuluar në Prishtinë. Edhe pse disa prej personave të arrestuar kanë një të shkuar kriminale, nuk ka prova që tregojnë se janë pjesë e një organizate kriminale.⁴³

Kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme po bëhet gjithnjë e më i përhapur në Ballkanin Perëndimor, duke ndjekur trendin në Evropë dhe në mbarë botën. Agjencitë e zbatimit të ligjit duhet të caktojnë burime të mjaftueshme dhe t'i japin prioritet kapjes së personave dhe grupeve kriminale që përfshihen në kultivimin në ambiente të brendshme, si edhe zbulimit të laboratorëve të tyre të paligjshëm të

drogës. Siç kemi parë në Kosovë, kultivimi i kanabisit në ambiente të brendshme është një krim i organizuar ndërkombëtar, në të cilin trendet e njërit vend prekin lehtësisht edhe të tjerët. Prodhimi i kanabisit në Shqipëri dhe transferimi i njohurive nga prodhimi i ligjshëm i kanabisit në Maqedoninë e Veriut ka ndikuar te prodhimi i paligjshëm i kanabisit në Kosovë dhe në rajon. Prandaj, agjencitë e zbatimit të ligjit në rajon duhet të shkëmbejnë informacion në mënyrë aktive dhe të rritin bashkëpunimin.

Rezultatet e Kosovës në vitin 2022 u arritën nga efikasiteti i bashkëpunimit të mirë mes zbatimit të ligjit dhe prokurorisë, ku policia e Kosovës luajti rol të rëndësishëm. Në këtë mënyrë agjencitë e zbatimit të ligjit ishin në gjendje ta mbanin nën kontroll kultivimin e kanabisit në ambiente të brendshme. Megjithatë, teksa grupet kriminale e përshtatnin vazhdimisht modelin e tyre të biznesit, do të jetë e vështirë që zbatimi i ligjit të vazhdojë të ruajë ritmin.

Shënime

- 1 EMCDDA, *Drug-related health and security in the Western Balkans*, 2022, https://www.emcdda.europa.eu/publications/regional-reports/drug-related-health-and-security-threats-western-balkans_en; *Cannabis*, Europol, <https://www.europol.europa.eu/crime-areas-and-statistics/crime-areas/drug-trafficking/cannabis>.
- 2 UNODC, *Drug Market Trends: Cannabis Opioids, World Drug Report 2022*, qershor 2022, https://www.unodc.org/res/wdr2022/MS/WDR22_Booklet_3.pdf.
- 3 EMCDDA, *Drug-related health and security in the Western Balkans*, 2022, https://www.emcdda.europa.eu/publications/regional-reports/drug-related-health-and-security-threats-western-balkans_en.
- 4 GI-TOC, *Global Organized Crime Index 2021*, shtator 2021, <https://ocindex.net/assets/downloads/global-ocindex-report.pdf>.
- 5 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 6 Intervistë me një oficer policie, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 7 Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email.
- 8 Ibid.
- 9 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 10 Intervistë me Safet Blakaj, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së Labyrinth, Prishtinë, 19 janar 2023.
- 11 EMCDDA, *Developments in the European cannabis market*, qershor 2019, https://www.emcdda.europa.eu/publications/emcdda-papers/developments-in-the-european-cannabis-market_en.
- 12 Ibid.
- 13 UNODC, *Drug Market Trends: Cannabis Opioids, World Drug Report 2022*, qershor 2022, https://www.unodc.org/res/wdr2022/MS/WDR22_Booklet_3.pdf
- 14 Ibid.; Intervistë me Safet Blakaj, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së Labyrinth, Prishtinë, 19 janar 2023; intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 15 UNODC, 22 qershor 2010, *World Drug Report 2010*, https://www.unodc.org/documents/wdr/WDR_2010/World_Drug_Report_2010_lo-res.pdf.
- 16 National Drug Intelligence Center, *Indoor Cultivation Trends, Domestic Cannabis Cultivation Assessment 2009*, korrik 2009, <https://www.justice.gov/archive/ndic/pubs37/37035/indoor.htm#:~:text=Indoor%20cannabis%20cultivators%20are%20able,generally%20yield%20higher-potency%20marijuana>.
- 17 Komisioni Evropian, Raporti për Kosovën 2022, 12 tetor 2022, <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Kosovo%20Report%202022.pdf>; GI-TOC, *Hotspots of organized crime in the Western Balkans, Local vulnerabilities in a regional context*, maj 2019, <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>; Observatori i Ekonomive të Paligjshme në Evropën Juglindore, *Links between politics, ethnicity and organized crime in northern Kosovo*, GI-TOC, Buletini për rezikun #11, dhjetor 2021, <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-011/01-politics-ethnicity-organized-crime-in-northern-kosovo.html>.
- 18 GI-TOC, *Global Organized Crime Index 2021*, shtator 2021, <https://ocindex.net/assets/downloads/global-ocindex-report.pdf>.
- 19 EMCDDA, *Drug-related health and security in the Western Balkans*, 2022, https://www.emcdda.europa.eu/publications/regional-reports/drug-related-health-and-security-threats-western-balkans_en.
- 20 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 21 Intervistë me një oficer policie, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 22 Zeljko Trkanjec, *North Macedonia police seize 1.5 tons of marijuana*, EUROACTIV, 10 February 2022, https://www.euractiv.com/section/politics/short_news/north-macedonia-police-seize-1-5-tons-of-marijuana/.
- 23 EMCDDA, *Illicit drug markets and supply in the Western Balkans: Impact of Covid-19*, qershor 2021, https://www.emcdda.europa.eu/publications/ad-hoc-publication/illegal-drug-markets-and-supply-western-balkans-impact-covid-19_en.
- 24 Intervistë me Safet Blakaj, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së Labyrinth, Prishtinë, 19 janar 2023; intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 25 UNODC, *Drug Demand Drug Supply, World Drug Report 2022*, qershor 2022, https://www.unodc.org/res/wdr2022/MS/WDR22_Booklet_2.pdf.
- 26 Ibid.
- 27 Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email.
- 28 Intervistë me një gazetar investigativ, Prishtinë, 18 janar 2023; intervistë me Safet Blakaj, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së Labyrinth, Prishtinë, 19 janar 2023; intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 29 Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email.
- 30 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 31 Policia e Kosovës, vlera e kanabisit të konfiskuar në ambiente të brendshme, 13 mars 20023, me email.
- 32 Sipas Policisë së Kosovës, vlera lokale e 1 kilogram kanabis të prodhuar në ambiente të brendshme është 2 000 €.
- 33 Albin Kurti, 2022: Qeveria kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, 9 janar 2023, https://m.facebook.com/story.php?story_fbid=pfbid02cYTSScap7duKhjv6WetFMwt9ETkaXpMh3wgQj745DjNychHqt5Zx7mQ8vkMkUpkHl&id=100044512086347&mibextid=kdkkhi.
- 34 Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email.
- 35 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 36 Edicioni special, Klan Kosova, 23 maj 2022, https://www.youtube.com/watch?v=dECi_ApziqA.
- 37 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 38 Ibid.
- 39 Intervistë me një gazetar investigativ, Prishtinë, 18 janar 2023.
- 40 Adelina Ahmeti, Si u zbulua laborator i drogës në mulli në Suharekë?, Kallxo.com, 22 shkurt 2022, <https://kallxo.com/lajm/si-u-zbulua-laboratori-i-droges-ne-mulli-ne-suhareke/>; Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email.
- 41 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 42 Policia e Kosovës, statistikat e kultivimit të kanabisit në ambiente të brendshme, 6 janar 2023, me email; intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.
- 43 Intervistë me një oficer policie të antidrogës, Prishtinë, 27 janar 2023.

Të miturit e pashoqëruar përballen me udhëtime të vështira gjatë rrugës së emigrimit nga Ballkani Perëndimor në BE.

Në shkurt 2023, policia e Sllovenisë – në bashkëpunim me autoritetet e zbatimit të ligjit nga Austria, Kroacia, Hungaria, Italia dhe Rumania – arrestuan 13 persona të dyshuar për kontrabandimin e njerëzve. Personat e arrestuar me origjinë nga Sllovenia, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina dyshohej se ishin përgjegjës për kontrabandimin e më shumë se 200 emigrantëve në BE. Së bashku me armët dhe mijëra fishekë, policia gjeti drogë dhe para.¹

Kriminelët i reklamoni aktivitetet e tyre të paligjshme – duke përfshirë video që dokumentonin transportet e suksesshme – në platforma të ndryshme të rrjeteve sociale për t'i joshur emigrantët që të kalonin kufijtë në

mënyrë të paligjshme. Ata i transferonin emigrantët në dy rrugë kryesore, ose nga Kroacia përmes Sllovenisë në Itali, ose nga Serbia dhe Hungaria në Austri. Emigrantët që përdorin shërbimet e kontrabandimit paguanin çmime të larta për të hyrë në BE: një udhëtim i paligjshëm nga Serbia në Austri kushtonte rreth 5 000 € për person dhe i gjithë udhëtimi nga vendi i origjinës në BE zakonisht kushtonte midis 15 000 € dhe 20 000 €.²

Emigracioni në rrugën e Ballkanit ka qenë në rritje që prej vitit 2019,³ dhe numri i kalimeve të paligjshme të kufirit është rritur gjatë pandemisë COVID-19.⁴ Në vitin 2022, më shumë se u zbuluan më shumë se 330 000 hyrje të parregullta në kufijtë e jashtëm të BE-së, i cili është numri



Armë të konfiskuara në një operacion të Europol i cili çoi në arrestimin e 13 personave të dyshuar për kontrabandimin e personave, shkurt 2023.

Burimi: Europol

më i madh që prej vitit 2016. Hyrjet e paligjshme përmes rrugës së Ballkanit kanë arritur majat, duke arritur numrin më të lartë të regjistruar që prej vitit 2015.⁵

Sipas një oficeri policie nga Bosnja dhe Hercegovina, shteti është një 'rrugë më e përshtatshme fitimi' për trafikantët.⁶ Emigrantët nga Afrika dhe Azia po hyjnë gjithnjë e më shumë në mënyrë të paligjshme përmes Bosnjës dhe Hercegovinës nga Mali i Zi dhe Serbia. Nga atje përpiqen të kalojnë kufirin në Kroaci.⁷ Sipas Frontex, shtetasit sirianë dhe turq ishin më të shpeshtit, dhe shtetasit e vendeve të tilla si, Tunizia, Burundi dhe India, të cilat më parë ishin të rrallë, janë vërejtur në rrugët e Ballkanit në vitin 2022.

Profili i njerëzve që lëvizin është gjithashtu duke ndryshuar. Një numër gjithnjë e më i madh i fëmijëve janë përpjekur të futen në BE, sidomos djemtë e rinj nga Afganistani, që kur talebanët morën pushtetin në gusht 2021. Afganët tani përbëjnë rreth 49% të banorëve që kampeve refugjate në Bosnjë dhe Hercegovinë.⁸

Së bashku me numrin e madh të njerëzve që lëvizin, ekziston një rrezik gjithnjë e më i madh i shfrytëzimit nga rrjetet e kontrabandimit. Një punonjës i një organizate ndërkombëtare që mbështet emigrantët tha se 'njerëzit që lëvizin shpesh janë më të pambrojtur'. Edhe pse organizatat mund të raportojnë për shfrytëzimin e emigrantëve, shpesh këto raporte nuk sjellin asnjë ndryshim. 'Nuk ekziston vullnet për t'i hetuar më tej këto raporte, nga organizatat ndërkombëtare tek autoritetet lokale,' tha punonjësi.⁹

Shpesh fëmijët emigrantë me familjet e tyre janë viktime të dhunës, diskriminimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Fëmijët e pashoqëruar¹⁰ janë edhe më të ekspozuar ndaj shfrytëzimit dhe dhunës. Zakonisht ata udhëtojnë me familjarë të largët, por bashkohen edhe me persona të panjohur gjatë rrugës për të shmangur qëndrimet e gjata në kampet e refugjatëve. Edhe pse kjo bëhet për t'i mbrojtur, kjo i ekspozon ata ndaj rreziqeve të reja.

Fëmijët emigrantë në rrezik

Në shumicën e rasteve, fëmijët e pashoqëruar bëhen viktime të shfrytëzimit seksual që në fillim të udhëtimit të tyre – një model që vazhdon përgjatë rrugës së emigrimit, e cila zakonisht zgjat më shumë se një vit.

Sipas një studiuesi që heton shfrytëzimin seksual në Ballkanin Perëndimor, më shumë se 99% e fëmijëve të

pashoqëruar që janë larguar nga vendet e tyre janë viktime të trafikimit.¹¹

Një raport i vitit 2022 nga OJQ-ja Save the Children zbuloi gjithashtu se fëmijët emigrantë që kalojnë përmes Ballkanit Perëndimor në BE ishin shumë të rrezikuar ndaj dhunës.¹² Fëmijët që u intervistuan për raportin folën më së shumti për djem të pashoqëruar që ishin viktime të abuzimeve seksuale në rrugë. Asnjë prej fëmijëve të pyetur nuk tha se kishte qenë viktimë e abuzimit seksual, por pothuajse dy të tretat raportuan një ose më shumë raste në të cilat dalluan shenja ose ishin dëshmitarë të këtyre abuzimeve.¹³

Shpesh fëmijët nuk flasin për shfrytëzimin seksual, madje nuk u tregojnë as familjarëve të ngushtë. Fëmijët mund të ngurrojnë të flasin për këtë ngaqë kanë frikë ose turp, dhe për të mbrojtur privatësinë dhe mirëqenien e tyre psikologjike, intervistuesit nuk këmbëngulin që të marrin përgjigje dhe nuk zhbirojnë më thellë. Fëmijët e intervistuar në rrugën e Ballkanit shpesh nuk kanë pranuar se ka ndodhur një gjë e tillë ose ndonjëherë e kanë treguar si diçka normale si një formë e pritshme e abuzimit të pushtetit. Kjo e bën mjaft të vështirë dallimin e kësaj lloji dhune.¹⁴

Një vështirësi tjetër gjatë hetimit të këtyre aktiviteteve kriminale është se rrallëherë fëmijët janë në dijeni të të drejtave të tyre dhe varen te më të rriturit në grupin e tyre, të cilët shpesh janë keqbërësit.¹⁵ Një problem tjetër është se këta fëmijë nuk janë të regjistruar dhe nuk qëndrojnë në të njëjtin vend apo në të njëjtin shtet për kohë të gjatë. Ekziston njëfarë frike se nëse i raportojnë incidentet në polici, do t'i detyrojnë të kthehen në vendin e origjinës. Ndaj është e vështirë të merren informacione dhe të dhëna të sakta, edhe kur kontaktohen organizatat ndërkombëtare ose vendëse që punojnë në kampe

Sipas nenit 3 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, 'Në të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët ... rëndësi parësore duhet t'u kushtohet interesave të fëmijëve'.¹⁶ Përgjatë rrugës së Ballkanit, kjo dispozitë nuk zbatohet. Megjithatë ka raste të rralla në të cilat është zbuluar shfrytëzimi seksual i fëmijëve të pashoqëruar, dhe zbatimi i ligjit dhe prokurorët kanë marrë masa për t'i mbrojtur viktimat.

Në shkurt 2022 u ekspozuan raste të shfrytëzimit seksual në Oraje, Bosnjë dhe Hercegovinë, ku disa viktime ishin të mitur.¹⁷ Si keqbërësit e dyshuar, ashtu edhe viktimat u



FIGURA 1 Lëvizja e fëmijëve emigrantë përmes Ballkanit Perëndimor.

Burimi: Save the Children

përkisnin popullatës emigrante që qëndronte në qendrat e pranimit në vend, dhe ishin nga Afganistani dhe Pakistani. Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe institucionet partnere po punojnë për të siguruar provat e nevojshme për të ndjekur penalisht keqbërësit, dhe për t'u kujdesur e për t'i mbrojtur viktimat.

Një përgjigje e tillë është diçka e pazakontë. Në shumicën e rasteve, fëmijët janë viktimat të padukshme: edhe kur identifikohen rastet e shfrytëzimit seksual, përsëri ndërmerren shumë pak masa. Sipas një përfaqësuesi të shoqërisë civile që punon me emigrantët në Tuzla, Bosnjë dhe Hercegovinë, një kontrabandist që

ndodhej në qendrën e pranimit të emigrantëve po kryente sheshit veprime të paligjshme. Kur ai kontrabandoi njerëz përgjatë rrugës së Ballkanit, ai ishte gjithnjë i rrethuar nga djem të rinj që i drejtoheshin me fjalët 'baba' ose 'xhaxha'. Ngaqë e thërrisnin si një pjesëtar të familjes, kjo ia bënte më të lehtë t'u afrohej djemve dhe të mos ndahej prej tyre në kampe, dhe i jepte mundësi t'i shfrytëzonte seksualisht.¹⁸ Në raste të tjera, kur kontrabandonte njerëz përtej lumit Drina nga Serbia në Bosnjë dhe Hercegovinë, djemve lihehin të drejtonin varkat. Të miturit, kryesisht fëmijë të pashoqëruar, drejtonin varkat ngaqë sepse nëse

kapeshin, nuk mbanin përgjegjësi sipas ligjit. Por liroheshin dhe vendoseshin në një qendër refugjatësh.¹⁹

Sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile që punojnë me emigrantët, problemi i hetimit të shfrytëzimit seksual të fëmijëve të pashoqëruar vuan për shkak se mungon interesi nga zbatimi i ligjit, si edhe ngaqë mungojnë kërkimet në terren: 'Edhe pse disa organizata dhe persona kanë marrë të dhëna në lidhje me ekzistencën e shfrytëzimit seksual mes fëmijëve të pashoqëruar, kjo nuk mjaftonte për t'i bindur autoritetet të nisin hetime,' tha një aktivist.²⁰

Një nga mënyrat për të pakësuar rrezikun e shfrytëzimit seksual të fëmijëve që udhëtojnë në BE përmes Ballkanit Perëndimor është që personat ndihmojnë emigrantët në kampe të fitojnë besimin e fëmijëve. Kjo do të thotë se duhet të përmirësohet komunikimi dhe bashkëpunimi mes institucioneve, organizatave dhe personave që janë pjesë e rrjetit të mbrojtjes, si dhe rritjen e komunikimit të sistemit të mbrojtjes me refugjatët dhe emigrantët. Kjo përfshin rritjen e ndërgjegjësimit lidhur me rreziqet e shfrytëzimit seksual të fëmijëve. Për të respektuar interesat e fëmijëve që lëvizin, zbatimi i ligjit, sistemi i mirëqenies sociale, organizatat ndërkombëtare dhe shoqëria civile duhet të punojnë së bashku për të adresuar nevojat e të miturve të pashoqëruar.

Shënime

- 1 EUROPOL, *13 criminals arrested for smuggling at least 212 people*, 16 shkurt 2023, <https://www.europol.europa.eu/media-press/newsroom/news/13-criminals-arrested-for-smuggling-least-212-people>.
- 2 Ibid.
- 3 Frontex, *Migratory routes, Western Balkan route*, <https://frontex.europa.eu/what-we-do/migratory-routes/western-balkan-route/>.
- 4 MARRI, *Analysing the influence of COVID-19 on migration in the MARRI participants*, 25 janar 2021, http://marri-rc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/FINAL-REPORT_Analysing-the-influence-of-COVID-19-on-migration-in-the-MARRI-Praticipants-1.pdf?fbclid=IwAROKLKKk275b50Q71vMqOXxZ9e781PfdV5sYoPf5iePilGoqWfUfMEPpJLU.
- 5 Frontex, *EU's external borders in 2022: Number of irregular border crossings highest since 2016*, 13 janar 2023, <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/eu-s-external-borders-in-2022-number-of-irregular-border-crossings-highest-since-2016-YsAZ29>.
- 6 Intervista me një oficer policie në Bosnjë dhe Hercegovinë, Sarajevë, 30 nëntor 2022.
- 7 Ibid.
- 8 *Povećan broj migranata u BiH izvan privremenih prihvatnih centara*, Fokus, 3 nëntor 2022, <https://www.fokus.ba/vijesti/bih/povecan-broj-migranata-u-bih-izvan-privremenih-prihvatnih-centara/2430706/>.
- 9 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile dhe punonjës në një organizatë ndërkombëtare në Una-Sana Canton, Bosnjë dhe Hercegovinë, 21 janar 2023.
- 10 Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) e përkufizon një fëmijë të pashoqëruar si 'një person që është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç, përveç kur, sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, moshë madhore është arritur më herët dhe që "është i ndarë nga të dy prindërit dhe nuk përkujdeset nga një i rritur i cili sipas ligjit ose zakonisht ka përgjegjësi për ta bërë këtë". Shiko UNHCR, *Guidelines on policies and procedures in dealing with unaccompanied children seeking asylum*, shkurt 1997, <https://www.unhcr.org/media/guidelines-policies-and-procedures-dealing-unaccompanied-children-seeking-asylum>.
- 11 Eventi i nxjerrjes së raporteve, 'Wherever we go, someone does us harm: Violence against refugee and migrant children arriving in Europe through the Balkans', Save the Children, Sarajevë, 29 nëntor 2022.
- 12 Save the Children, *Wherever we go, someone does us harm: Violence against refugee and migrant children arriving in Europe through the Balkans*, gusht 2022, <https://resourcecentre.savethechildren.net/document/wherever-we-go-someone-does-us-harm-violence-against-refugee-and-migrant-children-arriving-in-europe-through-the-balkans>.
- 13 Ibid.
- 14 Intervistë me një psikolog në Bosnjë dhe Hercegovinë, 21 dhjetor 2022.
- 15 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile që punon me njerëzit në lëvizje, Sarajevë, 10 dhjetor 2022.
- 16 Kombet e Bashkuara, *Convention on the Rights of the Child*, 20 nëntor 1989, <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-child>.
- 17 A Deković, *BIH: Pronađeni dokazi o zlostavljanju i seksualnoj eksploataciji migranata*, Anadolu Agency, 24 shkurt 2022, <https://www.aa.com.tr/ba/balkan/bih-pronadeni-dokazi-o-zlostavljanju-i-seksualnoj-eksploataciji-migranata/2512450>.
- 18 Intervistë me një përfaqësues të shoqërisë civile që punon me emigrantët në Tuzla, 15 janar 2023.
- 19 Intervistë me një inspektor policie në Sarajevë, 1 shkurt 2023.
- 20 Intervistë me një aktivist të shoqërisë civile që punon me njerëzit në lëvizje, Sarajevë, 10 dhjetor 2022.

Grupet kriminale shqiptare të organizuara janë bërë aktorë kryesorë në mjedisin kriminal të Italisë, duke ngritur nevojën për operacione të posaçme nga autoritetet.

Në fillim të vitit 2023, një gjykatës në Trento, një qytet në veri të Italisë pranë kufijve me Zvicrën dhe Austrinë, dënosi 28 veta me burg, dhe dënimet varionin nga tetë muaj deri në pesë vjet, pasi u akuzuan në operacionin e antidrogës Continuo a spacciare (Unë vazhdoj të trafikoj). Hetimi, i cili përfundoi në mars 2022, zbuloi një rrjet kompleks të grupeve kriminale – shumë me kombësi shqiptare, në bashkëpunim me italianë dhe marokenë – të përfshirë në trafikimin e kokainës në Evropë. Sipas policisë së Italisë, selia dhe qendra logjistike për tregtinë e paligjshme ishte Café 34 në zemër të qytetit.¹

Hetimet hodhën dritë mbi një sistem të sofistikuar që ishte krijuar për të kryer trafikimin e kokainës nga Evropa lindore në zonën e Trentino dhe në rajone të tjera të Italisë me lidhje në Austri. Si rezultat i operacionit, kafeneja u konfiskua dhe më shumë se 50 veta u arrestuan. Përveç kësaj, policia konfiskoi 21 kilogramë drogë, €85 795 para cash dhe sende luksoze me vlerë €35 000.

Depërtimi i grupeve kriminale nga Shqipëria në Trento thekson përshtatjen e lartë dhe zhvillimin e shpejtë të grupeve shqiptare të krimit të organizuar në Itali – edhe në një zonë që gjithmonë është perceptuar si zonë 'pa mafia'. Konfiskimi i Café 34 nuk duhet të konsiderohet si një rast i izoluar, por si provë e zgjerimit prej kohësh të ndikimit të grupeve shqiptare të krimit të organizuar në Evropën Perëndimore dhe në veçanti në Itali. Sipas Indeksit Global të Krimit të Organizuar dhe divizionit anti-mafia të Italisë, grupet shqiptare të krimit të organizuar janë një prej grupeve të huaja më të fuqishme të krimit të organizuar që operojnë në Itali.²

Aktualisht shqiptarët janë një prej komuniteteve të huaja më të mëdha në Itali, të cilët përbëjnë rreth 11,5% të shtetasve që nuk janë pjesë e BE-së. Në vitin 2020, rreth 416 000 shtetas shqiptarë jetonin ligjërisht në Itali.³ Këto shifra nuk përfshijnë fëmijët që u kanë lindur

emigrantëve shqiptarë me shtetësi italiane ose nga çifte të përziera italo-shqiptare. Disa analistë përlogaritën se rreth 25 000–30 000 fëmijë shqiptarë të gjeneratës së dytë kanë lindur pa shtetësi italiane.⁴ Komuniteti shqiptar është integruar në faktorë të rëndësishëm të ekonomisë italiane, si sektori i ndërtimit dhe fusha industriale. Gjatë viteve 2020 deri në 2022, përqindja e punësimit të shqiptarëve në Itali ishte 56,2% krahasuar me 60,1% për të gjithë shtetasit që nuk janë pjesë e BE-së që jetojnë në vend.⁵ Megjithatë, cënueshmëria dhe pasiguria ekonomike i kanë nxitur disa shqiptarë të kërkojnë mundësi të paligjshme.

Ndërkohë që kriminelët shqiptarë në qytete të mëdha si Roma marrin shumicën e vëmendjes (shiko më poshtë), në dhjetë vitet e fundit, disa grupe kriminale shqiptare janë transferuar në qytete më të vogla në veri të Italisë. Grupet shqiptare kanë krijuar prezencë të fortë në qytetet pranë Varese, Como dhe Lecco, siç bëhet e ditur nga operacionet White Eagle në 2010 dhe Bardhy në 2022. Operacioni White Eagle zbuloi lidhjet e kriminelëve shqiptarë në Lombardi dhe në rajonet përreth: droga importohet nga Holanda, Suedia dhe Austria, dhe më pas shpërndahej përmes rajoneve të Lombardisë, Piemontes, Emilia-Romanjës dhe Lacios.⁶ Në zonën e Komos u krye operacioni Bardhy, në të cilin u ekspozua një rrjet i madh shqiptar i trafikimit të drogës në Itali: kokaina importohet nga Holanda përmes qyteteve të Breneros (Itali) dhe Frejus (Francë), ndërsa kanabisi vinte nga Shqipëria përmes rajonit italian të Pulias. Heroina importohet nga Turqia përmes Sllovenisë në provincën e Triestes.⁷

Në Varese, krimi i organizuar shqiptar kishte rrënjë të thella: në nëntor 2011, 500 kilogramë kanabis – gati për t'u shpërndarë në Itali dhe Zvicër – u konfiskuan në një magazinë që zotërohej nga shqiptarë.⁸ Në operacionet Illyricum dhe The Diggers, të cilët u kryen paralelisht në tetor 2021, autoritetet e zbatimit të ligjit identifikuan dhe shkatërruan grupet kriminale shqiptare të trafikimit

të drogës në zonën e Aostës në kufi me Francën dhe në qytetin e Teramo, në pjesën rurale qendrore-jugore të Italisë.⁹ Operacioni Kanun në Arezo, Toskanë, në vitin 2002 bëri të mundur arrestimin e një bosit shqiptar 37-vjeçar me leje qëndrimi të rregullt. Ai u zbulua fajtor për drejtimin e një rrjeti të trafikimit të drogës që përbëhej nga më shumë se 100 kriminelë me origjinë shqiptare të shpërndarë në gjithë vendin.¹⁰

Arezo ishte përsëri në krye të artikujve mediatikë në nëntor 2021 falë kërkimit që policia i bëri një kamioni që u ndalua në një autostradë, në të cilin ishin fshehur 476 kilogramë kokainë me vlerë tregu prej 45 milionë € – konfiskimi më i madh i kokainës në Arezo deri më sot. Shoferi ishte shqiptar dhe rezident prej kohësh i Firences. Ai u zbulua teksa transportonte kokainë përgjatë A1, autostrada më e ngarkuar që lidh Italinë qendrore me rrugëkalimin në malin Brenner, hyrja për në Evropën perëndimore.¹¹

Dhuna dhe shqiptarët e gjeneratës së dytë në Romë

Ndërkohë që grupet shqiptare të krimit të organizuar i kanë zgjeruar fshehtas veprimtaritë e tyre në Italinë e veriut, dhuna dhe sjellja e shfrenuar janë të dukshme mes bosëve shqiptarë të rinj e të vetëshpallur në Romë. Në dhjetë vitet e fundit, operacione të mëdha policore të tilla

si, Batteria di Ponte Milvio dhe Grande Raccordo Criminale tregojnë se si shqiptarët e gjeneratës së dytë – fëmijët e refugjatëve që kanë ardhur me një valë të madhe diaspore në fillim të viteve 1990 – kanë fituar mjaft respekt te të rinjtë kriminelë lokalë për të drejtuar pjesë të mëdha të tregut të drogës për shkak të mënyrës agresive si i kontrollojnë territoret e tyre.¹² Kjo gjeneratë e kriminelësh ka lindur dhe është rritur në Itali. Pjesëtarët e rinj të familjeve shqiptare me histori kriminale e kanë ndarë qytetin mes tyre. Ata e njohin territori dhe dinë si të lëvizin në të; ata flasin dialektin roman dhe nuk kanë frikë as nga konkurrenca, as nga policia.

Në prill 2022, policia e Romës arrestoi Elvis Demce, një shqiptar i gjeneratës së dytë dhe një udhëheqës bande i pashpirt. Arrestimi i tij parandaloi vrasjen e dy pjesëtarëve të një grupi rival, me sa duket për shkak të një mosmarrëveshjeje për konflikt interesi në bizneset e ndërtimit dhe pronave të paluajtshme. Për këtë rast, ai kishte blerë pushkë M16 dhe AK-47, armë të tjera të ndryshme dhe një bazukë me të cilën kishte ndërmend të 'digjte shtëpinë e rivalit'.¹³

Në Romë – një qytet që historikisht është kontestuar nga bandat lokale, mafia tradicionale e jugut të Italisë dhe grupet e huaja – shqiptarët kanë treguar se kanë



Oficerët e policisë së Guardia di Finanza italiane duke patrulluar në Ostia, qarku bregdetar i Romës.

Foto: Tiziana Fabi/AFP via Getty Images

aftësinë të bashkëpunojnë në mënyrë oportuniste, duke u futur në heshtje në qendrat më fitimprurëse të trafikimit të drogës. Ky përfundim vjen nga hetimi policisë së Romës në vitin 2015 Mondo di mezzo, falë të cilit u arrit të shkatërrohej një grup kriminal italo-shqiptar. Grupi kishte krijuar një aleancë ngjashëm mafias për të kontrolluar tregun e kokainës dhe për t'u zhvatur para në mënyrë sistematike pronarëve të bizneseve në Ostia, një zonë bregdetare pranë Romës.¹⁴

Operacioni Brasile low cost në vitin 2017 konfirmoi ekzistencën e një 'bashkëpunimi të fortë afatgjatë' mes bosëve historikë të mafias së Romës të kalibrit Fabrizio Piscitelli (i ashtuquajtur Diabolik) dhe Salvatore Casamonica me bosin shqiptar ndërkombëtar të drogës Dorian Petoku, i cili u arrestua në Shqipëri në vitin 2019 dhe më pas u ekstradua në Itali.¹⁵ Sipas policisë, ky nivel i lartë bashkëpunimi kishte për qëllim të ruante paqen mes klaneve të ndryshme që konkurronin për furnizimin e tregjeve evropiane me kokainë përmes Italisë qendrore dhe për garantimin e kanaleve të qëndrueshme të furnizimit të drogës nga Brazili përmes Spanjës.¹⁶

Përgjatë viteve, periferitë e Romës u bënë tregu kryesor i drogës në qytet dhe një prej zonave më të rëndësishme të trafikimit në Itali. Një operacion në shkurt 2021 i koordinuar nga Europol tregon nivelin që arritën shqiptarët në zinxhirin e furnizimit. Ky operacion rrëzoi serverin e komunikimit sekret Sky ECC, i cili përmbante biseda të enkriptuara të 170 kriminelëve, të cilët ishin të bindur se mund të komunikonin lirshëm. Bisedat private treguan madhësinë dhe shkallën ndërkombëtare të grupeve shqiptare të krimit të organizuar: kokaina, e cila fillimisht blihej dhe merrej pranë Napolit, mbërrinte në Romë e fshehur në kuti që mbartnin kivi nga Ekuadori. Ajo

mbërrinte në anije mallrash që kishin ndaluar në Marok, ku grupet kishin lidhur marrëveshje me ushtrinë. Pasi mbërrinte në Itali, ajo transportohej në kamionë nga Gioia Tauro, një port kalabrez që kontrollohej nga 'Ndrangheta'.¹⁷

Përveç këtyre lidhjeve me kriminelët vendës, përgjatë viteve, shumë shqiptarë ishin në gjendje të depërtonin në zonat gri të shoqërisë së lartë italiane. Disa figura publike, italiane dhe shqiptare, u raportuan se kishin krijuar lidhje me grupet kriminale shqiptare, si Alessandro Corvesi (një ish-futbollist) dhe kampioni i boksit Oriol Kolaj.¹⁸ Prania e shqiptarëve në mjedisin kriminal italian është kaq e rrënjësor thellë sa që mund të thuhet se ata janë ngjitur tashmë në shkallët e krimit dhe e kanë legjitimizuar rolin e tyre si partnerë të barabartë me mafien tradicionale italiane.¹⁹

Zgjedhja e vendit për veprimtaritë e tyre nuk duket se ishte rastësi. Shumë qytete të vogla ku grupet shqiptare të krimit të organizuar ishin vendosur, janë shumë pranë qendrave logjistike ndërkombëtare ose kufijve ndërkombëtarë. Kjo tregon gjithashtu natyrën ndërkombëtare të shumë prej veprimtarive të këtyre grupeve. Italia verilindore – sidomos në zonën mes Trentos, Veronës dhe Venecias – është çelësi për qarkullimet e paligjshme, pasi ofron të gjitha mundësitë logjistike të nevojshme për të lëvizur mallrat e paligjshme. Ky trend për t'u zgjeruar në qytetet e vogla dhe strategjike ka shumë gjasa të vazhdojë. Por ndërsa taktikat e grupeve shqiptare të krimit të organizuar evoluojnë, po kështu ndodh edhe me taktikat e policisë. Sipas prokurorit italian Nicola Gratteri, hetimet e ardhshme në Itali do të fokusohen në masë të madhe dhe progresive të grupeve ngjashëm mafias nga Shqipëria.²⁰

Shënime

- 1 Trento Today, *La storia del Café 34 finisce con 28 condanne*, 4 mars 2023, <https://www.trentotoday.it/cronaca/cafe-34-ventotto-condanne-inchiesta-guardia-finanza.html>.
- 2 GI-TOC, *Global Organized Crime Index 2021*, shtator 2021, <https://ocindex.net/assets/downloads/global-ocindex-report.pdf>; dhe Ministria e Brendshme e Italisë, *Relazione del Ministro dell'Interno al Parlamento sull'attività svolta e risultati conseguiti Direzione Investigativa Antimafia*, janar-qershor 2021 dhe korrik-dhjetor 2021, <https://direzioneinvestigativaantimafia.interno.gov.it/relazioni-semestrali/>.
- 3 Romano Carabotta, *Ne impediatur legatio: analisi storica e geopolitica dei rapporti tra Italia ed Albania*, *Opinio Juris*, 18 shkurt 2022, <https://www.opiniojuris.it/ne-impediatur-legatio-analisi-storica-e-geopolitica-dei-rapporti-tra-italia-ed-albania/>.
- 4 Ketij Biçoku, *Cittadini italo-albanesi: la carica dei 200 mila*, *Osservatorio Balcani Caucaso*, 26 shkurt 2018, <https://www.balcanicaucaso.org/aree/Albania/Cittadini-italo-albanesi-la-carica-dei-200-mila-185685>.
- 5 Romano Carabotta, *Ne impediatur legatio: analisi storica e geopolitica dei rapporti tra Italia ed Albania*, *Opinio Juris*, 18 shkurt 2022, <https://www.opiniojuris.it/ne-impediatur-legatio-analisi-storica-e-geopolitica-dei-rapporti-tra-italia-ed-albania/>.
- 6 Silvia Savoye, *Operazione White Eagle: la sentenza agli inizi di giugno*, 20 maj 2010, *AostaSera*, <https://aostasera.it/notizie/cronaca/operazione-white-eagle-la-sentenza-agli-inizi-di-giugno/>.
- 7 Maurizio Franco, Youssef Hassan Holgado dhe Filippo Poltronieri, *Così i narcos albanesi fanno affari con le organizzazioni criminali che dominano Roma*, *IRPI Media*, 18 janar 2023.

- <https://irpimedia.irpi.eu/narcos-albanesi-dominano-roma-casamonica/>.
- 8 LaRepubblica, *Varese, in garage 5 quintali di marijuana: tre arresti*, 28 nëntor 2011, <https://video.repubblica.it/edizione/milano/varese-in-garage-5-quintali-di-marijuana-tre-arresti/81811/80201>.
 - 9 EkuoNews, *Operazione The Diggers, sgominata rete di spaccio tra Teramo e L'Aquila: 8 arresti ma 5 irreperibili*, 7 tetor 2021, <https://www.ekuonews.it/07/10/2021/operazione-the-diggers-sgominata-rete-di-spaccio-tra-teramo-e-laquila-8-arresti-ma-5-irreperibili/>.
 - 10 *Da Arezzo dirigeva la cosca sgominata la mafia albanese*, La Repubblica, 25 maj 2002, <https://ricerca.repubblica.it/repubblica/archivio/repubblica/2002/05/25/da-arezzo-dirigeva-la-cosca-sgominata-la.html>.
 - 11 *Arezzo, quattro quintali di cocaina nell'autocarro del muratore. Sequestro record: valore 45 milioni. I retroscena*, Corriere di Arezzo, 10 nëntor 2021, <https://corrierearezzo.corr.it/news/arezzo/29398131/arezzo-polizia-guardia-di-finanza-cocaina-firenze-albania-droga.html>.
 - 12 Për shembull: *Mafia Capitale, dagli albanesi ai napoletani: Ponte Milvio terra di conquista dei clan*, RomaToday, 9 dhjetor 2014, <https://www.romatoday.it/cronaca/batteria-ponte-milvio-mafia-capitale.html>; Mauro Cifelli, *Il Grande Raccordo Criminale per inondare Roma di droga: 51 arresti, Diabolik a capo dei narcos*, RomaToday, 28 nëntor 2019, <https://www.romatoday.it/cronaca/grande-raccordo-criminale-arresti-roma-oggi.html>.
 - 13 Andrea Ossino, *Il boss albanese e quel bazooka per sventrare la casa di un imprenditore: 'Ma quando je damo du' botte a sti indegni?'*, La Repubblica, 17 prill 2022, https://roma.repubblica.it/cronaca/2022/04/16/news/un_bazooka_per_il_proprietario_della_cavese-345657882/.
 - 14 *Mondo di Mezzo, dagli arresti alle sentenze: cosa c'è da sapere*, Sky tg24, 22 tetor 2019, <https://tg24.sky.it/cronaca/approfondimenti/mafia-capitale>.
 - 15 Andrea Ossino, *Mafia albanese, il giudice scarcerò il re dei narcos: 'È tossicodipendente'*, La Repubblica, 26 tetor 2022, <https://roma.repubblica.it/cronaca/2022/10/25/news/giudice-scarcerò-re-dei-narcos-e-tossicodipendente-371675590/>.
 - 16 A Mar, *'Se vengono in aereo, so' guardie'*, Dagospia, 17 shkurt 2020, <https://www.dagospia.com/rubrica-29/cronache/39-39-se-vengono-aereo-so-39-guardie-39-39-summit-227130.html>.
 - 17 Carlo Bonini, *Criptomafia*, La Repubblica, 16 dhjetor 2021, https://www.repubblica.it/cronaca/2021/12/16/news/criptomafia_come_telefoni_criptati_encrochat_e_sky_ecc_le_nuove_armi_di_narcos_e_criminali_globali_sono_finite_nella_ret-330203679/.
 - 18 Oriol Kolaj, *pugile e esattore del clan dei Casalesi ad Acilia (Roma)*, Blitz, 30 tetor 2013, <https://www.blitzquotidiano.it/rassegna-stampa/orial-kolaj-pugile-per-conto-dei-casalesi-massari-sul-fatto-quotidiano-1705840/>; *Omicidi su commissione: l'ex giocatore della Lazio Corvesi e Er Principe dell'Olgiate*, Fanpage.it, 1 gusht 2022, <https://www.fanpage.it/roma/omicidi-su-commissione-lex-giocatore-della-lazio-corvesi-e-er-principe-killer-per-hobby/>.
 - 19 Direzione Nazionale Antimafia, *Raporti vjetor, 1 July–30 qershor 2012, dhjetor 2012*, https://www.stampoantimafioso.it/wp-content/uploads/2013/01/DNA_Dicembre-20121.pdf.
 - 20 Jamil El Sadi, *Mafie in Europa, Gratteri: 'Un problema poco visibile ma forte e pervasivo'*, Antimafia Duemila, 12 prill 2022, <https://www.antimafiaduemila.com/home/mafie-news/309-topnews/89055-mafie-in-europa-gratteri-un-problema-poco-visibile-ma-forte-e-pervasivo.html>.

Buletinet e Rreziqeve janë publikime periodike nga observatorët tanë rajonalë, në bashkëpunim me rrjete të shoqërisë civile për të paraqitur të dhëna të reja dhe për të kontekstualizuar prirjet e rrjeteve të krimit të organizuar, tregtisë së paligjshme, dhe reagimit të shtetit ndaj tyre. Nëse doni të abonoheni për të marrë numrat e ardhshëm të “Buletinit të rreziqeve”, ju lutemi regjistrohuni këtu ose dërgoni email në Vanja.Petrovic@globalinitiative.net.

MBI “INCIATIVËN GLOBALE”

Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është një rrjet mbarëbotëror, i përbërë nga më shumë se 600 ekspertë të shpërndarë nëpër të gjithë globin. Iniciativa Globale ka krijuar një platformë për nxitjen e një debati më të gjerë dhe promovimin e përjasjeve inovative, për të krijuar një bazë të fortë për hartimin e një strategjie në nivel global kundër krimit të organizuar.

www.globalinitiative.net

Ky publikim u realizua me mbështetjen financiare të Fondit të Mbretërisë së Bashkuar për Konflikt, Stabilitet dhe Siguri. Përgjegjësia mbi përmbajtjen e këtij publikimi bie vetëm mbi GI-TOC, dhe përmbajtja nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Mbretërisë së Bashkuar.



**GLOBAL
INITIATIVE**
AGAINST TRANSNATIONAL
ORGANIZED CRIME